

Dr. Muhamet Shatri

IBRAHIM MANSUR EFENDIU DHE SHQIPËRIA NËN SUNDIMIN E ALI PASHË TEPELENËS

(Mr. Shefki Luma, *Ibrahim Mansur Efendiu dhe Shqipëria nën sundimin e Ali Pashë Tepelenës*, Tetovë, 2002, f. 150.)

Botimi i përgatitur nga Mr. Shefki Luma, "Ibrahim Mansur Efendiu dhe Shqipëria nën sundimin e Ali Pashë Tepelenës", doli nga shtypi në vitin 2002.

Objekt i këtij botimi janë kujtimet e një francezi nga Strazburgu me emrin Samson Serfbir, i cili për të përmbushur një mision diplomatik në dobi të shtetit të tij, mori rrugën për në vendet e lindjes. Në rrugë e sipër ai ra në duart e Ali Pashë Tepelenës dhe mbeti për vite të tëra mysafir i tij.

Në këtë kuptim, botimi i kujtimeve paraqet interes të posaçëm, sepse në të kanë zënë vend dëshmitë e një udhëtari perëndimor që jetoi për shumë kohë pranë oborrit të Pashait të Janinës dhe që pa nga afër doket e zakonet e bano-rëve, jetën ekonomikë – shoqërore, zhvillimet politike, marrëdhëniet ndëretnike në këtë pashallëk etj.

Në pjesën e kujtimeve mbi Greqinë dhe Shqipërinë gjejmë të dhëna të shumta gjeografike, etnografike dhe historike, sepse autori i tyre ka një kujtesë të jashtëzakonshme dhe një pasion të madh për udhëtimet, që ndërmori jo vetëm në Greqi e Shqipëri por edhe në Azi, Afrikë dhe në Amerikë.

Mr. Shefki Luma, Kujtimet e Ibrahim Mansurit na i jep në mënyrë origjinale, duke u ndalur në momentet më të rëndësishme dhe duke i interpretuar ato me mjeshtri të rrallë. Ai njëherazi ruan me besnikëri frymën, idetë, porosinë origjinale dhe konceptimin e autorit.

Në kreun e parë por dhe të dytë, z. Luma që është një njohës i mirë i letërsisë frenge, ndalet dhe analizon gjininë e kujtimeve, si një nga gjinitë e përdorura gjërësisht në letërsinë frënge të shek. XVIII dhe XIX. Në të njëjtën kohë, ai ndalet në formën që ka përzgjedhur autori dhe sidomos në ideologjinë që e frymëzoi atë dhe që është në harmoni të plotë me frymën, idetë, ideologjinë që karakterizoi shoqërinë evropiane që jetonte momente të rëndësishme, në periudhën ndërmjet tiranisë dhe fymës liberale që sollen revolucioni dhe luftërat e Napoleonit.

Magjister Sh. Luma me të drejtë konston se kujtimet e Ibrahim Mansur Efendiut nuk janë vetëm pasqyrim i peripecive të jetës së autorit të tyre, por ato na japin edhe një kuadër historik të rëndësishëm për Shqipërinë gjatë sundimit të Ali Pashë Tepelenës.

Natyrisht, në këtë vepër ka edhe vlerësime që nuk qendrojnë. Të tilla janë pohimet e autorit të kujtimeve, se toskët ishin më shumë në numër se gegët; ato që bëjnë ndarjen e leberve dhe të çamëve, nga toskët. Interes paraqesin pikpamjet dhe vlerësimet e autorit për popullsinë çame. Për ta ai flet me simpati të veçantë dhe thekson se ishin njerëz të ashpër, fanatikë, të pavarur dhe anarkistë dhe se tek anarkia çamët gjenin shprehjen më të qartë të lirisë.

Ibrahim Mansuri përshkruan, sipas këndvështrimit të tij, edhe disa veçori të shqiptarëve të konfesionit katolik dhe tek atë vlerëson korrektesën, fisnikërinë, urtësinë dhe zemërgjerësinë. Mbi bazën e këtyre përshkrimeve, ai arrin në përfundimin se shqiptarët ishin një popull i zoti, i mësuar me punë nga më të vështirat dhe të gatshëm për të bërë sakrifica. Ata, konkludon ai, janë ushtarë të mirë për këmbësorinë e lehtë, janë të shkathët, të stërvitur për t'u ngjitur në shkëmbinj, mjeshtër të lëvizjeve në terren dhe të aftë për të përfutuar nga mundësia më e vogël që u krijohej. Autori, vëren me të drejtë se Ali Pasha ishte i vetmi sovran musliman që pranonte të krishterët në shërbimin ushtarak. Interes paraqesin edhe të dhënat që sjell autori për numrin e përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë, që sipas tij, në atë kohë arrinte në 1.073.190 frymë. Kujtimet janë të pasura edhe me të dhëna për mënyrën e veshjes së popullit shqiptar.

Autori, siç është e kuptueshme, i kushton vëmendje të veçantë biografisë së Ali Pashë Tepelenës. Ai përshkruan origjinën, pamjen fizike, sjelljet, shpirtin mizor dhe hakmarrës të pashait të Janinës, por dhe aftësitë dhe energjinë e tij të jashtëzakonshme. Ne e kemi të vështirë të pranojmë konstatimin e autorit, se të parët e Ali Pashë Tepelenës ishin me origjinë nga Anadulli, që u vendosën në Shqipëri pas pushtimit osman, aq me tepër, kur vërejmë dhe analizojmë përpjekjet e tij për krijimin e shtetit autonom shqiptar. Vrojtimit të Ibrahim Mansurit nuk i ka shpëtuar edhe ndikimi i nënës në formimin e personalitetit të Ali Pashë Tepelenës. Për të pohuar këtë konstatim, ai citon edhe pohimin që Ali Pasha i kishte bërë konsullit freng, Pukvilit, të cilit i kishte pohuar se "i detyrohem për gjithçka nanës sime se ajo më ka dhënë dy herë jetën; më bëri njeri dhe vezir, me zbuloi sekretet e fatit tim".

Në kreun e tretë, Mansuri ka bërë objekt shqyrtimi e vlerësimi, sipas këndvështrimit të tij, personalitetin e Ali Pashë Tepelenës, i cili gëzonte autoritet dhe famë në të gjithë Shqipërinë. Interes për lexuesin paraqesin mënyra e tij e qeverisjes dhe e të bërit të politikës, shpirti intrigant, ambicioz.

Kreu i katërt i kushtohet aspekteve etno-kulturore të Shqipërisë, dhe në veçanti, veshjeve, mënyrës së jetesës, gjendjes shoqërore dhe organizimit politik të shqiptarëve. Këtë realitet autori e kundron në disa drejtime, duke na dhënë dëshmitë e tij për mënyrën e të ushqyerit, të veshjeve, për gjuhë shqipe, për besimin dhe për mënyrën e ushtrimit të fesë nga shqiptarët.

Por, ashtu siç mund të konstatohet edhe gjatë leximit të kujtimeve, autori për shumë arsye nuk mund të arrijë në sqarimin dhe argumentimin e plotë të të gjitha problemeve të shqyrtuara, të hynte në brendësinë e shumë prej zhvillimeve apo ngjarjeve të kohës. Megjithatë, botimi përbën një dëshmi autentike, që ndihmon për ndërmarrjen e studimeve më të thelluara dhe në një kuadër më të përgjithshëm.

Në përfundim mund të konstatojmë se ky botim përbën një dëshmi të rrallë për personalitetin e Ali Pashë Tepelenës, si edhe për sfidat nëpër të cilat kaloi shoqëria shqiptare në fund të shek. XVIII dhe në fillimet e shek. XIX. Ndërcohë, shumë nga problemet, vlerësimet dhe zhvillimet e asaj periudhe nuk e kanë humbur aktualitetin, por vazhdojnë të jenë objekt i shqyrtimi, në artikujt studimorë, monografisë dhe diskutimet shkencore.

